

Mbi Auditimin e Ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime Durrës

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime, Durrës, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga data 01.01.13 deri më 30.04.14, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 118 datë 15.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 526/15 datë 15.09.2014, dërguar Z. Spartak Kovaçi, Drejtor, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i aktivitetit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ka rezultuar një punë e dobët, si në planifikimin e auditimeve vjetore ashtu edhe në realizimin e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të menaxhuar arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të shoqërisë, duke i lënë hapësirën e nevojshme sipas ligjit për auditin e brendshëm, njesisë së auditit të brendshëm për një përcaktim të drejtë të autoritetit dhe përgjegjësisë, gjatë punës së tyre audituese, duke bërë planifikime auditimesh që do të sillnin zbulime të anomalive, parregullsive dhe të gabimeve në entitet, për realizimin e objektivave të UKD SHA.

Vazhdimisht.

2. Nga UKD Sh.a nuk janë marrë masa për përgatitjen dhe nënshkrimin e deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi përgatitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" gjatë vitit të mëparshëm dhe në vazhdim, për entitetin publik që mbulon.

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i UKD-së në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë Teknike dhe Njësinë e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për përgatitjen dhe nënshkrimin e deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi përgatitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" gjatë vitit të mëparshëm dhe në vazhdim, për entitetin publik që mbulon, gjithashtu të marrë masa për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të entit si dhe të mbështetësve strukturat drejtuese të UKD SHA, në arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të shoqërisë.

Vazhdimisht.

3. Në lidhje me veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës është konstatuar se, si për vitin 2013 ashtu dhe për vitin 2014, niveli i shpërblimit është referuar në masën 30 % të pagës së Drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë për Kryetarin e KMb dhe 20 % për anëtarët e KMb, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar pika 6.c. Si pasojë e këtij veprimi, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës kanë përfituar padrejtësisht, për vitin 2013 me vlerë 128,331 lekë dhe për vitin 2014, me vlerë 310,800 lekë.

Për këtë rekomandojmë:

Asambleja e Aksionerëve të SHA UK Durrës, të marrë masa për përcaktimin e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar pika 6.c.

Brenda Muajit shtator 2014.

4. UKD Sh.a nuk i është përmbajtur programit ekonomik mbi numrin e punonjësve gjatë viteve 2013 dhe 2014, duke e tejkaluar numrin e parashikuar edhe pse fondi i pagave është brenda limitit të planifikuar. Gjithashtu ka tejkalim të zërave të shpenzimeve për provizione dhe zëra të tjerë.

Për këtë rekomandojmë:

UKD Sh.a t’i përmbahet programit ekonomik dhe financiar për numrin e punonjësve dhe zërat e tjerë të shpenzimeve të programit ekonomik, duke mos i tejkaluar ato.

Vazhdimisht.

5. Nivelet e pagave janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të shoqërisë, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar në Vendimin e Këshilli i Ministrave, por nuk janë miratuar nga ministri e linjës, në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKD të marrin masa që niveli i pagave dhe i shpërblimeve të miratohen në ministrinë e linjës sipas përcaktimeve në ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me kontratën kolektive të punës dhe aktet e tjera të shoqërisë.

Vazhdimisht.

6. UKD Sha gjatë vitit 2013 është ndëshkuar me gjoba dhe pagesa interesi për pagesë të vonuar të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën 280,253 lekë, si rezultat i mungesës së aftësisë paguese.

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masa për pagesën brenda afatit të caktuar të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të evitohen rëndimet e buxhetit të shoqërisë si pasojë e gjobave dhe interesave për shkak të pagesës së vonuar.

Vazhdimisht.

7. Si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, UKD Sha për periudhën objekt auditimi është penalizuar nga vendimet e gjykatave në shumën 1,938,007 lekë. Për këto arsye shoqëria është penalizuar edhe nga vendime të marra para periudhës së auditimit por që likuidimet vazhdojnë edhe gjatë periudhës së auditimit me vlerë 1,897,741 lekë. Penalizimet janë rënduar akoma më shumë si rezultat i mungesës së ekzekutimit vullnetar të këtyre vendimeve.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë së UKD dhe departamentet përkatëse, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për penalizimin e UKD Sha si rezultat i vendimit të gjykatave për largime nga puna pa shkaqe të përligjura.

Brenda muajit Tetor 2014.

8. - Për periudhën objekt auditimi janë kryer blerje për bileta udhëtimi jashtë vendit në shumën **742,380 lekë**, pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat duhura për zbatimin e procedurave të prokurimit publik sipas kërkesave ligjore për kryerjen e shpenzimeve për blerje bileta udhëtimi jashtë vendit, si dhe likuidimi i shpenzimeve të bëhet me plotësimin e të gjithë dokumentacionit ligjor përkatës.

Vazhdimisht.

9. Janë konstatuar mangësi në mënyrën e plotësimit të dokumentacionit që pasqyron kilometrat e përshkruara për automjete, i cili është plotësuar në disa raste pa përcaktuar destinacionin, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për mirëadministrimin e shpenzimeve për karburante, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë shërbimet që pasqyrojnë kilometrat e përshkruara prej tyre, cilësimin e destinacionit dhe

distanca, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Vazhdimisht.

10. Për prokurimet me vlera të vogla UKD Sh.A nuk ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla, duke mos parashikuar natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit, nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, ku thuhet se “Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë”.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masa për hartim e regjistrin të parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla, duke parashikuar natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen.

Vazhdimisht.

11. Për disa nga procedurat e prokurimit të realizuara është tejkaluar limiti ligjor prej 480 mijë lekë/vit, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 26.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2/a dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI pika 2/a.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme dhe të bashkërendojnë punën me departamentet dhe repartet, për të programuar saktë nevojat për prokurimet me vlera të vogla për punë, mallra dhe shërbime, të përcaktojnë grup mallra e shërbime sipas natyrës së përdorimit, për të shmangur copëzimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit me efektivitet, transparencë dhe konkurrencë të operatorëve ekonomikë.

Vazhdimisht.

12. Investimet e parashikuara në programet e zhvillimit ekonomiko-financiare të shoqërisë, për vitin 2013, janë realizuar në masën 74.4% dhe për vitin 2014 në progresin e deri tanishëm ka prirje për mosrealizim në shkallën e duhur.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të marrin masa për rritjen e shkallës së realizimit të investimeve të programuara për të arritur përfitimet e pritura.

Vazhdimisht.

13. Për vitin 2013, vëllimi i ujit të prodhuar në sistem është 27,351 milion m³, nga kjo, janë faturuar 7,828 milion m³ ujë, ose 29 % e vëllimit të ujit të prodhuar në sistem pjesa tjetër përbën humbje teknike. Humbjet teknike në nivel kaq të lartë kanë ardhur si rezultat i amortizimit të rrjetit, kontratave dyshe, pasaktësisë në matje por edhe nga mosmenaxhimi në shkallën e duhur.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të marrin masa për rritjen e sasisë së ujit të faturuar dhe uljen e shkallës së humbjeve duke rritur numrin e kontratave, rritjen e planit të vendosjes së sahateve matës për abonentët.

Vazhdimisht.

14. Performanca e UKD Sh.A është në nivele shumë të ulta si pasojë e nivelit të ulët të sasisë së ujit të faturuar krahasuar me atë të prodhuar, si pasojë e nivelit të lartë të humbjeve teknike duke marrë parasysh edhe faktin se uji prodhohet me ngritje mekanike.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i përgjithshëm dhe departamentet përkatëse të rrisin performancën e UKD Sh.A, duke marrë masa për reduktimin e humbjeve teknike të ujit, rritjen e faturimit dhe arkëtimit.

Vazhdimisht.

15. Vlera e kërkesave të arkëtueshme është ulur në krahasim me vitin e mëparshëm prej 2,005,359,933 lekë, një pjesë e kësaj si rezultat i fshirjes së llogarive të arkëtueshme si rezultat i amnistisë dhe jo si pasojë e arkëtimit të këtyre vlerave. Nga analiza e llogarit/kërkesave të arkëtueshme rezulton se një pjesë e kërkesave janë pa shpresë arkëtimi, për të cilën duhej krijuar provizionin i tyre sipas SKK6.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse të marrin masat e nevojshme për të bërë ndjekjen sistematike dhe të vazhdueshme të arkëtimeve dhe mbajtjen e kërkesave të arkëtueshme të klasifikuara sipas afateve të maturimit të tyre.

Vazhdimisht.

16. Shoqëria nuk ka paguar detyrimet ndaj furnitorëve e kreditorëve gjendja e të cilëve në fund të viteve 2012 e 2013 është përkatësisht 561 milionë lekë dhe 569 milionë lekë. Këto detyrime përbëjnë risk, për pagesa gjobash e penalitete, për moslikuidim në kohë të detyrimeve kontraktuese, për furnizimin me mallra, punë dhe shërbime nga të tretët.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masa për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe aktuale ndaj furnitorëve dhe kreditorëve.

Brenda vitit 2014.

17. UKD SHA nuk ka marrë masa për të përshpejtuar procedurat e rilicensimit për kategorinë D, për trajtimin e ujërave të ndotura sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, metodologjinë për vendosjen e tarifave miratuar me vendimin nr. 28, datë 28.09.2011 të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU, nr. 24, datë 3.06.2013 “Për disa ndryshime në vendimin e KKRR nr. 36, datë 19.12.2011 “Për miratimin e tarifave për konsum publik për SHA UK Durrës” dhe për shfuqizimin e vendimit të KKRR nr. 24, datë 01.10.2012 “Për miratimin e tarifës së shërbimit për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura për SHA UK Durrës”.

Për këtë rekomandojmë:

UKD SHA nën mbikëqyrjen e Këshillit Mbikëqyrës të marrë masa për të përshpejtuar procedurat e rilicensimit për kategorinë D, për trajtimin e ujërave të ndotura sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996

Brenda vitit 2014.

18. UKD SHA, nuk i ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara dhe konkretisht kontratën nr.08, datë 15.07.2013, e ndryshuar, pasi likuidimi i detyrimit ndaj ERRU, deri më datën 30.04.2014 është 3,000,000 lekë, ndërsa deri më datën 23.06.2014 likuidimi i detyrimit është 4,200,000 lekë. Rezulton se Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA, vazhdon të jetë debitore ndaj ERRU dhe detyrimi financiar ndaj ERRU është 12,997,900 lekë.

Për këtë rekomandojmë:

UKD SHA, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara me ERRU dhe konkretisht kontratën nr. 08, datë 15.07.2013, e ndryshuar, duke i shlyer detyrimin financiar prej 12,997,900 lekë Entit Rregullator të Ujit, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, metodologjinë për vendosjen e tarifave miratuar me vendimin nr. 28, datë 28.09.2011 të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU, nr. 24, datë 3.06.2013 “Për disa ndryshime në vendimin e KKRR nr. 36, datë 19.12.2011 “Për miratimin e tarifave për konsum publik për SHA UK Durrës” dhe për shfuqizimin e vendimit të KKRR nr. 24, datë 01.10.2012 “Për miratimin e tarifës së shërbimit për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura për SHA UK Durrës”.

Brenda vitit 2014.

19. Nga auditimi i disa dosjeve të prokurimit rezulton se, mungon llogaritja e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, mungojnë nënshkrimet e ofertës fituese dhe procesverbalet e dorëzimit të dokumenteve të operatorit fitues në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:

UKD SHA, të marrë masa për të plotësuar mangësitë e konstatuara në dosjet e prokurimit sipas legjislacionit përkatës duke u bazuar në azhurnimet e vazhdueshme të ligjit për prokurimin publik dhe në rregullat për prokurimin publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vazhdimisht.

20. Nga auditimi rezulton se anëtarët e njësisë së prokurimit në UKD Sh.a, nuk kanë realizuar trajnime periodike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për këtë rekomandojmë:

UKD SHA, të marri masa që të trajnojnë anëtarët e njësisë së prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet e prokurimit publik nëpërmjet mbikqyrjes nga APP-ja, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vazhdimisht.

21. Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim emergjent i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të zonës Spitallë –Porto Romano- Bisht Pallë” është aplikuar procedura e prokurimit “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” nga ku konstatua se nga ana e Autoritetit Kontraktor, nuk është justifikuar nëse ka qenë e mundur ndjekja e procedurave standarde të prokurimit mbi ose nën kufirin e ulët monetar, nuk është vërtetuar dokumentuar dhe argumentuar se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi autoritetit kontraktor.

Për këtë rekomandojmë:

UKD SHA, të marrë masa për të zhvilluar procedura prokurimi që nxisin konkurrencën dhe që justifikojnë ndjekjen e procedurave standarde të prokurimit mbi ose nën kufirin e ulët monetar, kushte këto që i japin mundësi sa më shumë operatorëve në marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik në kushte të barabarta konkurruese.

Vazhdimisht.

24. Në auditimin e mëparshëm ka rezultuar se UKD Sh.a, nuk ka marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj stafit administrativ dhe menaxherial për mbifaturimet në Bashkinë Sukth. Edhe në auditimin e ushtruar për aktivitetin e shoqërisë për periudhën janar 2013-prill 2014, rezulton se nuk janë marrë masat sipas rekomandimit.

Për këtë rekomandojmë:

UKD Sha të shqyrtojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj stafit administrativ dhe menaxherial për mbifaturimet në Bashkinë Sukth. Ky rekomandim është lënë edhe në auditimin e mëparshëm, por nuk është marrë asnjë masë për këtë qëllim.

Menjëherë

25. Nga auditimi i zbatimit të kontratës: “Rikonstruksioni i Stacionit të Pompave Fushë-Kuqe” Durrës, ka rezultuar se UK Sha Durrës nuk ka marrë masat për nxjerrjen e lejes së ndërtimit nga Komuna Fushë Kuqe, për punimet që do të kryhen në tabanin e rrugës, duke u bërë pengesë për vazhdimin e punimeve të pezulluara.

Për këtë rekomandojmë:

UKD të marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor, për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit “Rikonstruksion i stacionit të pompave Fushë-Kuqe”.

Brenda muajit tetor 2014.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. SHA UK Durrës, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën **128,331 lekë** përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës për vitin 2013, sipas tabelës më poshtë:

Anëtarë të KMB	Pagesa mujore e realizuar (lekë)	Pagesa mujore sipas VKM. Nr 642 (lekë)	Diferenca x 9 muaj (Lekë)
	39,039	32,700	57,051
	26,060	22,100	35,640
	26,060	22,100	35,640
Shuma:			128,331

Menjëherë

2. SHA UK Durrës, të marrë masat e nevojshme për ndalimin e pagesës me vlerë **310,800 lekë** përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës për vitin 2014, sipas tabelës më poshtë (trajtuar më hollësisht në faqen 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit):

Anëtarë të KMB	Pagesa mujore e realizuar (lekë)	Pagesa mujore sipas VKM. Nr 642 (lekë)	Diferenca x 6 muaj (Lekë)
	45,000	32,700	73,800
	30,000	22,100	47,400
	30,000	22,100	47,400
	30,000	22,100	47,400
	30,000	22,100	47,400
	30,000	22,100	47,400

Shuma:			310,800
---------------	--	--	----------------

Menjëherë

3. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKD të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën **209,120 lekë**, për punonjësit të cilët në zbatimin e kontratave të shërbimit me operatorët e telefonisë celulare rezultojnë me detyrime ndaj shoqërisë, shumë e cila përbën dëm ekonomik.

Menjëherë

4. Drejtori i Përgjithshëm i SHA UK Durrës, gjatë procesit të likuidimit të pagesës së mbetur, të marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për zbritjen e vlerës **4,661,196lekë** përfituar padrejtësisht nga kontraktori [REDACTED] Shpk, për punime të certifikuara por të parealizuara, si dhe penalitetet për mos përfundim në afat të punimeve, rezultuar gjatë auditimit të zbatimit të kontratës “Përmirësimi i furnizimit me ujë, Lagje Sallmone dhe stallat, Komuna Xhafzotaj”, si më poshtë: Vlerë 1,746,289 lekë, penalizim për mos përfundim në afat të punimeve sipas kontratës. Vlerë 2,915,196 lekë, për punime të certifikuara por të pa realizuara..

Menjëherë

5. Drejtori i Përgjithshëm i SHA UK Durrës, të marrë masat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të arkëtuar shumën **3,353,229 lekë** përfituar padrejtësisht nga kontraktori [REDACTED] Shpk për punime të paguara por të parealizuara, rezultuar gjatë auditimit të zbatimit të kontratës “Rikonstrukcion i godinave të UKD” .

Menjëherë

6. Drejtori i Përgjithshëm i SHA UK Durrës, gjatë procesit të likuidimit të pagesës së mbetur, të marrë masa administrative e ligjore për zbritjen e vlerës **556,003 lekë** përfituar padrejtësisht nga kontraktori “[REDACTED]” Shpk, për punime të certifikuara por të parealizuara, rezultuar gjatë auditimit të zbatimit të kontratës “Ndërtim emergjent rrjet ujësjellësi në zonën e Spitallës, Porto Romano dhe Bisht Pallë, Durrës”.

Menjëherë

7. Drejtori i Përgjithshëm i SHA UK Durrës, gjatë procesit të likuidimit të pagesës së mbetur, të marrë masa administrative e ligjore për zbritjen e vlerës **492,444 lekë** përfituar padrejtësisht nga kontraktori “[REDACTED]” Shpk, për punime të certifikuara por të parealizuara, rezultuar gjatë auditimit të zbatimit të kontratës “Lagje Shahinaj, Katund i Ri”.

Menjëherë

8. Drejtori i Përgjithshëm i SHA UK Durrës, gjatë procesit të likuidimit të pagesës së mbetur, të marrë masa administrative e ligjore për zbritjen e vlerës **529,200 lekë** përfituar padrejtësisht nga kontraktori “[REDACTED]” Shpk, për punime të certifikuara por të parealizuara, rezultuar gjatë auditimit të zbatimit të kontratës “Rikonstrukcion i linjës së ujësjellësit Lagje 14, Shkozet Durrës”.

C. MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet publike për periudhën 01.01.2013 deri më 31.04.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në raportin përfundimtar të auditimit, bazuar në nenet 13 (pika “i”) dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i kërkohet Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative për punonjësit si më poshtë:**

1..

2

3. **në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sepse:**

- Nuk kanë hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla, duke mos parashikuar natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit, nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, ku thuhet se “*Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë.*”

- Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të prokurimit rezulton se në të gjitha procedurat e prokurimit mungon llogaritja e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, shkelje që ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit UKD SHA.

- Në dosjen e prokurimit “Rikonstruksioni dhe riorganizim funksional i godinave ekzistuese të UKD” mungon, dokumentacioni i operatorit ekonomik fitues “.” SHPK, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim emergjent i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të zonës Spitalë –Porto Romano- Bisht Pallë” nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aplikimin e procedurës së prokurimit “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” u konstatua se nga ana e Autoritetit Kontraktor në këtë rast UKD SHA:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Rikonstruksioni i tubacionit DN 400 CE Xhafzotaj – Rrashbull, Komuna Rrashbull**”, ku zj. ka qënë në cilësinë e anëtares së KVO-së janë evidentuar këto shkelje:

Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

4. **në cilësinë e anëtarit të KVO dhe ish -shefit të sektorit të prokurimeve dhe kryetar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sepse:**

-Ka kryer prokurimeve me vlera të vogla, pa regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla, në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit, nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, ku thuhet se

“Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë.”

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Përmirësimi i furnizimit me ujë lagja e Shahinëve, Komuna Katund i Ri”**, “Rikonstruksioni dhe riorganizim funksional i godinave ekzistuese të UKD” dhe “Rikonstruksioni i tubacionit DN 400 CE Xhafzotaj –Rrashbull, Komuna Rrashbull”, nga shqyrtimi i dokumentacionit për këto procedura rezultoi se KVO i referohet kësaj procedure me objekt **“Përmirësimi i furnizimit me ujë lagja e Shahinëve, Komuna Katund i Ri”** si kërkesë për propozim, ndërkohë që në urdhrin e prokurimit nr.1559 prot, datë 03.05.2013, është specifikuar që kjo procedurë të jetë “procedurë e hapur –punë”, në kundërshtim me VKM nr.1, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në procesverbalin e miratimit të dokumenteve të tenderit me objekt **“Ndërtim emergjent i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të zonës Spitallë –Porto Romano- Bisht Pallë”**, nr.1688 prot, datë 08.05.2013 , pika II, përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale , licensat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, thuhet shprehimisht se ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash. Nga verifikimi i dosjes së fituesit të tenderit , rezultoi se “██████” SHPK , nuk disponon certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash në dosjen e ofertës, ndërkohë KVO ka vlerësuar fitues “██████” SHPK, në kundërshtim me kriteret e kërkuara në kapacitetet teknike të dokumenteve standarte të tenderit, në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.01 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

5.. ██████

6.. ██████, në cilësinë e anëtarëve të KVO, sepse:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Përmirësimi i furnizimit me ujë lagja e Shahinëve, Komuna Katund i Ri”**, nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë procedurë rezultoi se KVO i referohet kësaj procedure si kërkesë për propozim, ndërkohë që në urdhrin e prokurimit nr.1559 prot, datë 03.05.2013, është specifikuar që kjo procedurë të jetë “procedurë e hapur –punë”, në kundërshtim me VKM nr.1, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

7. ██████ në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Rikonstruksioni dhe riorganizim funksional i godinave ekzistuese të UKD” dhe “Rikonstruksioni i stacionit të pompave në Fushë-Kuqe”**, nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë procedurë rezultoi se KVO i referohet kësaj procedure si kërkesë për propozim, ndërkohë që në urdhrin e prokurimit nr.1559 prot, datë 03.05.2013, është specifikuar që kjo procedurë të jetë “procedurë e hapur –punë”, në kundërshtim me VKM nr.1, “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

8.. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Rikonstruksioni i tubacionit DN 400 CE Xhafzotaj – Rrashbull, Komuna Rrashbull”**,

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në procesverbalin e miratimit të dokumenteve të tenderit me objekt **“Ndërtim emergjent i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të zonës Spitallë –Porto Romano- Bisht Pallë”**, nr.1688 prot, datë 08.05.2013 , pika II, përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale , licensat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, në pikën thuhet shprehimisht se ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash. Nga verifikimi i dosjes së fituesit të tenderit , u konstatua se “[REDAKTUAR]” SHPK , nuk disponon certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash në dosjen e ofertës, ndërkohë KVO ka vlerësuar fitues “[REDAKTUAR].” SHPK, në kundërshtim me kriteret e kërkuara në kapacitetet teknike të dokumenteve standarte të tenderit, në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.01 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

9.. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtares së KVO, sepse:

Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Rikonstruksioni i stacionit të pompave në Fushë-Kuqe”**

- Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

10. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

- Në procesverbalin e miratimit të dokumenteve të tenderit me objekt **“Ndërtim emergjent i rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë të zonës Spitallë –Porto Romano- Bisht Pallë”**, nr.1688 prot, datë 08.05.2013 , pika II, përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale , licensat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, në pikën thuhet shprehimisht se ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash. Nga verifikimi i dosjes së fituesit të tenderit , u konstatua se “[REDAKTUAR]” SHPK , nuk disponon certifikatë ISO për ndërtim ujësjellësash në dosjen e ofertës, ndërkohë KVO ka vlerësuar fitues “[REDAKTUAR].” SHPK, në kundërshtim me kriteret e kërkuara në kapacitetet teknike të dokumenteve standarte të tenderit, në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.01 “Për rregullat e prokurimit publik”.

- Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në dosjen e tenderit me objekt **“Rikonstruksioni dhe riorganizim funksional i godinave ekzistuese të UKD”** Oferta ekonomike fituese dhe preventivi i punimeve me zërat përkatës nuk është nënshkruar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

-Në dosjen e tenderit, mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

11.zj. [REDAKTUAR] me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve dhe në cilësinë e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, sepse:

- nuk ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2014, duke mos parashikuar natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit, nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, ku thuhet se *“Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë.”*

- ka vepruar pa plan në 2013

12. z. [REDAKTUAR], me detyrë shef i sektorit të prokurimeve, në cilësinë e ish - kryetar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla, sepse:

- Nuk ka hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimeve me vlera të vogla, duke mos parashikuar natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit, nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 16.07.2013, ku thuhet se *“Autoriteti kontraktor planifikon që në fillim të vitit buxhetor natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë.”*

II. SHA Ujësjellës-Kanalizime Durrës, mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenet 7, 9 dhe 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, Pika b, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë Durrës, ndëshkimin për kundërvajtje administrative dhe dënimin me gjobë në masën 50,000 lekë, për shpërkëmbje dhe mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:

1. “[REDAKTUAR]”
2. [REDAKTUAR]
3. [REDAKTUAR]
4. [REDAKTUAR]
5. [REDAKTUAR]
6. [REDAKTUAR]
7. [REDAKTUAR]

Pasi gjatë auditimit të kontratave të punimeve civile kanë rezultuar mangësi që kanë të bëjnë me:

-Në dosjet teknike nuk disponohet dokumentacionin për siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt.

-Në dosjen teknike nuk disponohet dokumentacionin për siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta.

- Në asnjë rast nuk është bërë bërë njoftim me shkrim në seksionin e urbanistikës pranë organeve tëqeverisjes vendore, Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik në nivel komune/bashkie/qarku, drejtoritë rajonale tatimore dhe INUK-në, sipas rasteve të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse.
- Në disa raste provat dhe testimet e realizuara nuk janë dokumentuar.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave kanë rezultuar diferenca të punimeve të realizuara në fakt krahasuar me ato të likuiduara, duke shkaktuar dëme ekonomike.

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, me ndryshimet e mëvonshme, si dhe Kontratën kolektive të punës nr. 901, datë 20.04.2010, të nënshkruar midis UKD Sha dhe Sindikatës së Pavarur dhe punonjësve të Shqipërisë, neni 47 “Masa disiplinore”, **kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm i UKD Sha të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:**

I, “Vërejtje”, për:

1.. [] në Cilësinë e Drejtorit Ekonomik :

- nuk ka kryer në kohë arkëtimin e detyrimeve si pasojë e largimit nga puna të punonjësve, veprim i cili ka sjellë debitorë në rritje, vështirësi dhe kosto për ndjekjen e tyre. Shuma totale e debisë e pa likuiduar nga punonjësit është **209,120 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.
- ka kryer blerje për bileta udhëtimi jashtë vendit në shumën 39,421 lekë pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
- Nuk ka zbatuar ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2011 dhe përcakton një sërë detyrimesh për tu përmbushur nga të gjitha nivelet e UKD-së, si mungesa e hartimit të regjistrit të riskut, plotësimi i pyetësorëve vetëvlerësimi të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në UKD SHA.
- Nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011,që përcaktojnë se “deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”

2. z. [] me detyrë drejtor teknik, sepse:

- ka rezultuar mangësi në mënyrën e plotësimit të dokumentacionit që pasqyron kilometrat e përshkruara për automjete, i cili është plotësuar në disa raste pa përcaktuar destinacionin, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

3. z. [] me detyrë specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore, sepse:

- nuk ka kryer në kohë arkëtimin e detyrimeve si pasojë e largimit nga puna të punonjësve, veprim i cili ka sjellë debitorë në rritje, vështirësi dhe kosto për ndjekjen e tyre. Shuma totale e

debisë e pa likuiduar nga punonjësit është **209,120 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Shënim: Masat disiplinore “Largim nga detyra” për z. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR], “Vërejtje me paralajmërim” për znj. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR] konsiderohen të ezauruara, sepse kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin.

E. KALLZIM PENAL

Bazuar shkeljet e konstatuara si dhe në nenet: 164 të shpërdorimit të kompetencave, 248 të shpërdorimit të detyrës dhe 258 të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike të Kodit Penal, është bërë kallzim penal, për 1 (një) person.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topiana, Jorida Zhegu, Ina Sokoli, Elira Kola, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT